Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 739/13
Datë: 23.10.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 22.10.2013 nxjerr këtë:

VENDIM

Kolegji" Biznesi", në Prishtinë, duhet plotësuar kushtet deri në afatin e caktuar (01.04.2014), për të marr akreditim dhe aprovim për këtë/o kualifikim/e:

1. **Zjarrfikës, me kodin e klasifikimit 5161 (niveli IV i KKK-së).**

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë: 22.10.2013, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe

- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Rekomandimet dhe kërkesat e parashtruara ndaj institucionit tuaj i gjeni në raportet e jashtme vlerësuese për validim dhe akreditim.

3.1. Për verifikimin e kushteve dhe rekomandimeve të caktuara , AKK mbledh panelin vlerësues të përbërë nga tre ekspert të fushave përkatëse.

3.2. Në bazë të rezultateve dhe rekomandimeve të dala nga vizita e eksperteve, KD i AKK-së do të marr vendim final për aprovim/akreditim ose mos aprovim/akreditim ndaj institucionit tuaj.

3.3. Institucioni "Kolegji Biznesi" obligohet që të marr mbi vete shpenzimet për ekspert (një ditë pune sipas UA nr.1/2011), institucioni është i liruar nga pagesat tjera administrative.

3. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

4. Vendimi u dërgohet:

- Kolegjit Biznesi;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi